Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Driton Fetaj	**22.12.2023**	**01.01.2024**	**2023/1019**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 15.12.2023, OE "Efa Dienstleistung GmbH - Dega ne Kosove"- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/1019, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Pastrimi i objekteve shendetesore te KPSH-se" me nr. të prokurimit: "616-23-4576-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINËS. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të, Hapur, lloji i kontratës:, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës 1.250.000.00 €. Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/1019 i dt:15.12.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Supozohet se janë shkelur dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lagjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

Neni 1, Qëllimi

Neni 4, Paragrafi. 1.26. Palë e interesuar

Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7, Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 53 Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve paragrafi 3

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës paragrafi 1.

Neni 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Ankesa e OE "Efa Dienstleistung GmbH - Dega ne Kosove"- Prishtinë, dërguar ne OSHP per– Autoriteti Kontraktues: Kuvendit komunës Prishtinës per pretendimet e shkelura ne ankes jan si me poshte.

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **616-23-4576-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-së**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**Efa Dienstleistung GmbH - Dega në Kosovë**
NUI	**810804999**
Adresa	**Rexhep Krasniqi PN**
Vendi	**Prishtin**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**044235532**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Meriton Morina**
Adresa elektronike	**efagroupshpk@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**15.12.2023**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-së

Njoftimi pë kontratë, dhe dosja e tenderit 22.05.2023

Data e ofertimit 23.06.2023

Hapja e ofertave 23.06.2023

Njoftimi i Autoritetit Kontraktues për dhënje kontrate 17.10.2023

Kërkesa për qasje në ofertën e rekomanduar 18.10.2023

Njoftimi mbi pezullimin e aktivitetit 23.10.2023

Njoftmiti i Autoritetit Kontraktues vendim për ri-vlerësim të ofertave 30.10.2023

Plotësimi i dokumenteve shtesë 30.10.2023

Njoftimi i Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit 23.11.2023

Kerkesa për rishqyrtim 28.11.2023

Njoftimi mbi pezullimin e aktivitetit 29.11.2023

Njoftimi I vendimit për refuzimin e Kërkeses për Rishqyrtim 07.12.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒ **Jo** ☐

PO referoju Ankeses

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A

te LPP-se.

PO referoju Ankeses

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1, Qëllimi

Neni 4, Paragrafi. 1.26. Palë e interesuar

Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7, Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 53 Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve paragrafi 3

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës paragrafi 1.

Neni 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar,

Sipas procesvebali të hapjes së ofertave në pjesëmarrje ishte edhe një OE i cili sipas njoftimit të AK është i papërgjegjëshëm edhe pse kishte ofertë me të lirë financiare e njëjta kishte dorzuar vetem certifikatën e biznesit dhe paramasen e çmimeve andaj nuk

mos e vlerësuar që të shkruajm më shumë për këtë ofertë pasiqë është ofertë jo serioze dhe si e till është vlerësuar sipas njoftimit, vendimit të autoritetit kontraktues është ofertë e pa përgjegjëshme dhe jo serioze.

Autoriteti kontraktues gjatë vlersimit të ofertave në perputhje të paragraift 1,2 dhe 3 të nenit 72 është dashur të kerkoj informacone shtes ku thuhet. nese një operator dorzon dokumente të gabuara ose jo të plota Autoritetet mund të kërkojn nga operatoret që ti dorzojn, sqarojn, plotsojn apo kompletojn informacionin dokumentacionin në afat të caktuar.

RERFEROJU ANKESES

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Mundesia reale e nënshkrimit të kontratës, siguracionet e ofertës, vazhdimi i tyre, kostoja ligjore e shkresave si kërkesa për interpretime, kërkesa për rivlerësim, Ankesa Koha e humbur, stresi etj

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

mos e vlerësuar që të shkruajm më shumë për këtë ofertë pasiqë është ofertë jo serioze dhe si e till është vlerësuar sipas njoftimit, vendimit të autoritetit kontraktues është ofertë e pa përgjegjëshme dhe jo serioze.

Autoriteti kontraktues gjatë vlersimit të ofertave në perputhje të paragraift 1,2 dhe 3 të nenit 72 është dashur të kerkoj informacone shtes ku thuhet. nese një operator dorzon dokumente të gabuara ose jo të plota Autoritetet mund të kërkojn nga operatoret që ti dorzojn, sqarojn, plotsojn apo kompletojn informacionin dokumentacionin në afat të caktuar.

RERFEROJU ANKESES

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Mundesia reale e nënshkrimit të kontratës, siguracionet e ofertës, vazhdimi i tyre, kostoja ligjore e shkresave si kërkesa për interpretime, kërkesa për rivlerësim, Ankesa Koha e humbur, stresi etj

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

KRITERET PËR VLERËSIM

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

PROCESVERBALI PËR EKZAMINIMIN , VLERËSIMIN DHE KRAHASIMIN E TENDERËVE

Në procesverbal, komisioni vlerësues duhet të jep informacione në detaje lidhur me përmbajtjen e secilit tender duke u bazuar në kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshtatshmërinë administrative:

1.	RIO PLUS SH.P.K. 811868340	
2.	ERIK SH.P.K. 810029018	
3.	Efa Dienstleistung GmbH - Dega në Kosovë 810804999	
4.	Schafberger Jr. GmbH - Dega Kosovë Dega në Kosovë 811167809	
5.	Grup i Operatorëve Ekonomik INTERNACIONAL GROUP BASE SH.P.K.; SKYFTERAT - LIVE SH.P.K.	
6.	Grup i Operatorëve Ekonomik LAGUNA SH.P.K.: Extreme Clean SH.P.K.	

Ekzaminimi , vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshtatshmërinë teknike:

Analiza e çmimit

	TENDERUESI	Informata në lidhje me gabimet ne llogaritje	Arsyet për refuzimin e tenderit për shkak të çmimit anormalisht të ulët
1.	RIO PLUS SH.P.K. 811868340	Ka bere gabime ne paramase	
2.	ERIK SH.P.K. 810029018	Ka bere gabime ne paramase	
3.	Efa Dienstleistung GmbH - Dega në Kosovë 810804999		
4.	Schafberger Jr. GmbH - Dega Kosovë Dega në Kosovë 811167809		
5.	Grup i Operatorëve Ekonomik INTERNACIONAL GROUP BASE SH.P.K.; SKYFTERAT - LIVE SH.P.K.		
6.	Grup i Operatorëve Ekonomik LAGUNA SH.P.K.: Extreme Clean SH.P.K.		

Informata shtese mbi sqarimet dhe shtojca e tenderit

	TENDERUESI	Informata shtese mbi sqarimet dhe shtojca e tenderit
1.	RIO PLUS SH.P.K. 811868340	
2.	ERIK SH.P.K. 810029018	
3.	Efa Dienstleistung GmbH - Dega në Kosovë	

	810804999	
4.	Schafberger Jr. GmbH - Dega Kosovë Dega në Kosovë 811167809	
5.	Grup i Operatorëve Ekonomik INTERNACIONAL GROUP BASE SH.P.K.; SKYFTERAT - LIVE SH.P.K.	
6.	Grup i Operatorëve Ekonomik LAGUNA SH.P.K.; Extreme Clean SH.P.K.	

Vërejtje përmbyllëse në lidhje me vlerësimin e tenderëve të përgjegjshëm:

Nese ka devijime mes te dhenave me poshte nga komisioni dhe atyre kategorite perkatese me larte atehere vlene konstatimi I dhen nga komisioni me poshte.

Erik :

Nuk e ka plotesuar paramses si duhet, pozicionin nr. 3 nuk ka dhene emimin dhe eleminohet automatikisht.
Përfaqësuesi I autorizuar nga kompania për Trajnimin e sigurisë dhe shendetiti ne pune është Valmira Bujupaj. e cila ka qene ne te njëjtin rol si staf edhe tek OE Schafberger, po ashtu I njejti staf ka qene person I autorizuar ne disa marrveshje ose kontrata me te cilat e ka prezentuar kompaninë Erik, ndërsa për këtë aktivitet ka qenë pjesëmarrëse fizikisht për dorëzim te sigurimit për kompaninë Schafberger, duke e patur këtë fakt komisioni ngre dyshime per bashkëpunim mes te dy kompanive, dhe aplikim ne te njëjtën procedure, qe sipas ligjit te prokurimit publik nuk lejohen bashkëpunime te fshehura. OE gjate procedurës i eshte bere pyetje se a mund te na njofloni se çfarë roli ka stafi Valmire Bujupi, dhe se a eshte OE ne dijeni se e njëjta punon edhe për një kompani tjetër. Përveç sqarimeve kërkojmë edhe kontratën e punës dhe dëshminë e listës se punëtorëve te deklaruar ne ATK. OE ka kthyer përgjigje duke sqaruar se Stafi Valmire Bujupaj ka qene staf i rregullt deri ne shtator te vitit 2022, ndërsa per kete vit 2023 ka dhene dëshmi te listës se ATK-se se e njëjta nuk eshte me staf.
Pergjigja e OE nuk ka qene e plote sepse nuk ka dhene dëshmi edhe te vitin 2022 per ta pare vertete se deri kur ka qene sfaf i kompanisë Valmira sidomos muajin Mars 2022 ne te cilin me datën e njejte daton vlerësimi i rrezikshmërisë per kompaninë Erik dhe kompaninë tjetër pjesëmarrëse Schafberger dhe ne te cilat z. Valmira ka qene person përfaqësues i te dy kompanive gjate vlerësimit te rrezikut.

Ne oferten e OE Shcafberger komisioni ka verejtur disa mangesi dhe paqartesi, komisioni e ka pare te arsyeshme te kerkoj sqarime me qellim te vleresimit te drejte te ofertes.
Komisioni i vlerësimit ka kërkuar te sqarohet mënyra e kalkulimit te vikendeve, tek kalkulimi I shpenzimeve te kompanisë tek analiza financiare shihet qe kompania kur ta bere kalkulim te ndërrimit te natës me shpenzimet e orëve shtese vetëm për 3 pika te objekteve shendetsore, ndërsa sipas dosjes se tenderit- Aneksi I tek oraret e ndërrimeve shihet qe janë gjithsej 4 pika me ndërrim te natës.
OE eshet pergjigja se punohet vetem ne tri qendra dhe jo kater siq eshte cekur ne dosje.
Kjo pegjigje nuk eshte e pranueshme sepse OE nuk ju ka permbajtur kerkesave te dosjes se tenderit, perkatesisht Ankesit I dhe orareve te cekura, ato jane krieterev te vendosura nga AK dhe nese OE ka menduar se oraret nuk jane reale ose ka gabime, ai ka mundur te beje kerkese per sqarime gjate afatit per sqarime para hapjes se tenderit dhe jo tani te ndryshoj ne analize financiare

Po ashtu kalkulimi I shpenzimeve te orëve te vikendeve nuk ka përfshirë te gjitha pikat e qendrave qe punojnë edhe ne vikende por ka kalkuluar veten 3 pika për vikende përgjigja e OE ne letër standarde nuk e sqaron se pse OE nuk i ka përfshire te gjitha pikat ku duhet te jepet shërbimi ne vikende por ne vetëm 3 pika te objekteve shendetsore.
Rrjedhimisht analiza financiare nuk është bere konform kërkesave te dosjes se tenderit dhe mos kalkulimi mire i saj e bene një oferte te papërgjegjshme.

Përfaqësuesi I autorizuar nga kompania për Trajnimin e sigurisë dhe shëndetit ne pune është Valmira Bujupaj, e cila ka qene ne te njëjtin rol si staf edhe tek OE Erik, po ashtu I njëjti staf ka qene person I autorizuar ne disa marrëveshje ose kontrata me te cilat e ka prezentuar kompaninë Erik, ndërsa për këtë aktivitet ka qenë pjesëmarrëse fizikisht për dorëzim te sigurimit për kompaninë Schafberger, duke e patur këtë fakt komisioni ngre dyshime për bashkëpunim mes te dy kompanive, dhe aplikim ne te njëjtën procedure, qe sipas ligjit te prokurimit publik nuk lejohen bashkëpunime te fshehura, OE i eshte bere pytje për sqarim se *A mund te na njoftoni se çfarë roli ka stafi Valmire Bujupi, a jeni ne dijeni se e njëjta punon edhe për një kompani tjetër. Përveç sqarimeve kërkojmë edhe kontratën e punës dhe dëshminë e listës se punëtorëve te deklaruar ne ATK.*
OE ne leter standarde për përgjigje ka deklaruar se pajtohet se z. Vamira është certifikuar për siguri dhe pune por nuk e cek kohen e cëritkemit, qe ne te vërtetë është koha e njëjtë ajo e marsit 2022, ditën kur edhe OE ERIK e ka bere vlerësimin e rrezikut ne pune me përfaqësuese Valmira Bujupi.
OE Scgafberger nuk e ka sjell dëshmi listën e ATK 2022 për ta pare qe a ka qene edhe z. Valmira Bujupaj staf i OE Schafberger siq ishte OE ERIK., ndërsa ka sjell vetëm Listen e vitit 2023 ku Valmirja eshte staf aktual, perderi sa OE ERIK e ka bere te kundërtën ne përgjigje, ka sjell Listen e vitit 2022 ndersa nuk e ka sjell Listen e vitit 2023. Dyshimet tona bazohen edhe kur vlerësojmë se OE Schafberger ne oferte ka dorëzuar vërtetimin e ATK te kompanisë ERIK, qe ne te vërtet nuk është në konzorcium me te për këtë aktivitet.
Ne e kuptojmë se është gabim teknik por pse ndodh qe një kompani te sjell ne oferte vërtetimin e një kompanie tjetër pjesëmarrëse.

Çmimi I ofruar për material shpenzues mujor është jashtëzakonisht e ulet, lista qe ka AK ka dhënë ne dosje ka gjithsej 32 produkte me sasi te ndryshme, çmimi I dhënë 75,057.48 euro per 36 muaj, qe ne baze mujore cmimi I materialit është 2084.93 euro. OE ne oferet dhe ne përgjigje te letrës standarde nuk na ka bindur se ka llogarit te sjell te gjitha furnizimin me atë çmim. OE nuk i dhene kalkulim te materialit ose ndonjë fature me çmim te tregut per ta bindur komisionin por është arsyetuar se faturat janë konfidenciale.
Me gjitha këto devijime nga dosja, dëshmia qe OE i ka sjell ne oferte dhe ne përgjigje te letrës standarde e bene këtë oferte te papërgjegjshme.

Rio - OE ka bere gabime ne llogaritje te paramases, OE ka dhene cmim 26,184.00, ndersa pas korigjimit cmimi del 27,130.12, dmth e tejkalon 2% e cmimit. Po ashtu oferta e OE Rio ka qene shume e manget, OE perveq FDT, paramases, certifikates se biznesit nuk ka ofruar dokumente tjera siq jane kerkuar ne dosje si dhe nuk e ka vazhduar sigurimin e tenderit pas kerkeses se AK-se te dates 23.10.2023. Perfundimisht oferta eshte e papergjegjshme. OE nuk e ka vazhduar vlefshmërinë e tenderit.

OE Laguna- Nuk e ka vazhduar sigurimin, Analiza financiare nuk e ka plotesuar si duhet Analizen financiare, ka llogaritur pune te nates vetem ne tri qendra te QKM-se dhe jo ne tri siq jane cekur ne Dosje me oraret me ndrrin 24 oresh:

- QKMF
- QMF 5
- QMF 4
- QMU

OE nuk I ka sjell te gjitha sasite e listes se paisjeve siq AK ka kerkuar ne dosje te tenderit, I mungon edhe 1 sasi per makine per pastrim te dyshemese sepse I ka vetem 17, mungon deshmia e makines per larjen e pllakave, pastaj I mungon makine per larjen dhe herjen e dyshemese (me akumulator ose rrym) ne sasi 15 dhe I mungon makine per largimin e bores edhe 2 sasi.
Gr. I OE, nuk e kan plotesuar certifikatet ISO siq jane kerkuar ne Dosjes te tenderit, kane sjell disa certifikata qe nuk jane ne emer te ndonjeres prej kompanive ne konzorcium dhe nuk jane sipas kerkesave siq AK I ka kerku ne dosje.
Gr. I OE nuk ka dhene deklarate se materialet e perdorura jane ekologjike dhe te atestuara ai dhe nuk ka sjell deshmi te produkteve me MSDS .

EFA –

OE nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes 1. Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit fiskale ka qenë prej jo më pak se 900.000,00 Euro, OE ka sjell deshmi CD per vitet 2020, 2021 dhe 2023, qe ne total bejne 821,00 dhe jo 900,000.

OE nuk e ka plotesuar si duhet FDT, tek nen kriteri per shpeshtine OE eshte dashur te caktoj sa here do te intervenoj ne nje ndermin prej 1 deri ne max 3, ndersa OE ka dhene shenim 7 here ne dite dhe ne javë 17 here, dmth OE nuk ju ka permbajtur te dhenave te AK, aq me shume kur kemi te bejme me plotesim te FDT qe eshte kusht administrative.

Tek analiza financiare OE nuk e ka plotesuar si duhet analizen financiare sepse nuk e ka bere llogaritjen e festive conform ligjit dhe kerkeses se dosjes, poashtu kontributin e punedhenesit e ka llogaritur dy here ne kalkulim te shpenzimeve.

OE nuk e ka plotesuar kerkesen me deshmite percjellese 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjtë pastrim në vlerë minimale prej 800.000,00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë).

OE pas vendimit te AK-se ka sjell ne sistem disa dëshmi për qarkullim financiar – pasqyra financiare nga kompania Ame ne Gjermani, por qe sipas komisionit kompania ka ofertuar e vetme dhe dokumentet tjera nuk janë relevante ne ofertën e prezantuar ne fillim.

OE ka sjell dëshmi te referencave ne gjuhen zyrtare gjuhen shqipe vetëm 709,610 euro, te tjerat jane ne gjuhen jo zyrtare ne gjuhen gjermane duke bere shkelje te LPP-neni 13 paragrafi 4.

OE nuk e ka plotësuar kërkesën me dëshmitë përcjellëse.

c) Operatori duhet te jete i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare te menaxhimit te mjedisit, ne lëmine e pastrimit te objekteve ISO Certifikate 14001 2018 (valide). Iso standard për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit ne pune- nuk e ka sjell aspak.

OE nuk e ka plotësuar kërkesën me dëshmitë përcjellëse - 9. Lista e pajisjeve a) Operatori Ekonomik duhet te ketë te gjitha llojet e makinave për pastrimin e dyshemesë dhe lustrimin 18. b) Makinë për larjen e pllakave 1 (një). c) Makinë për thithjen e ujit 4 (katër). d) Makine për larjen dhe terjen e dyshemeve (me akumulator ose me rryme) 15 (pesëmbëdhjete) e) Kova për pastrim 36 (tridhjetë e gjashte) f) Fshesa me korrent 18 (tetëmbëdhjetë) g) Makine për larjen e tepihëve dhe thithjen e ujit. h) 1 (një) Pikap. i) Makinë (kositëse) me motor për kositjen e barit 6 copa. j) (trimer) 8 copë. k) Makine për largimin e bores (freze) 3 copë • l)Karroce e madhe për pastrim te zyrave, sallave te operimit dhe ambienteve te ngjashme 18 cope m) auto kran me lartësi 25m 1 copë n) Kamionete ose traktor për bartje 1 copë- OE nuk 1 ka ofruar ne sasi te kerkuara, makineria Traktor eshte me afat te skaduar.

OE ka sjell dokumente ne gjuhen gjermane qe nuk është gjuhe zyrtare prandaj dokumentacioni është i papranueshëm.

IGB& Skyfterat- Sqarime

Ne oferte te OE është vërejtur një paqartësi e te dhënave prandaj Komisioni i vlerësimit kërkon te sqarohet për mënyrën e kalkulimit te vikendeve, tek analiza e cmimeve qe AK I ka kërkuar me datën 30.08.2023, OE ka kthyer përgjigje me datën 31.08.2023 ku ka sqaruar cmimet per vikende dhe festa. OE ka dhene kalkulimin e cmimit per vikende ka llogaritur si shpenzim per kompanine vetem përqindjen

(50%) te pagës bazë te asaj dite vikendi dhe nuk e ka llogaritur si shpenzim ditën shumëzuar me 1.5. Komisioni i rivlerësimit ka përsëri ka pasur paqartësi dhe ka bere kete pyetje: *Duke e ditur se te shpenzimet e pagave bruto i keni llogaritur 176 dite pune- zyrtare, Kërkohet sqarim qe shpenzimet e pagave te orarit te vikendeve ku i keni perfshire ne kalkulim pse si shpenzim keni prezentuar vetëm 0.5 dhe jo 1.5 te pageses baze te ditës se wikendit.*

OE ne letër stanadre tper sqarime nuk ka dhen përsëri detaje bindëse qe perse nuk e ka llogaritur shpenzimet e ditës 1.5 por 0.5% te pagesës baze.

Qmimi I ofruar per material shpenzues mujor eshte jashtëzakonisht e ulet, lista qe ka AK ka dhene ne dosje ka gjithsej 32 produkte me sasi te ndryshme, qmimi I dhene 13,743.72 euro per 36 muaj, qe ne baze mujore cmimi I materialit eshte 381.77 euro, komisioni i vlerësimit ka bere kërkesë per sqarime si me poshtë: *A mund te na sqaroni dhe te ja dërgoni nje analize te çmimeve te materialeve shpenzuese qe bashkërisht me sasitë te na japin çmimin mujor 381.77 euro, duhet te na dëshmoni çmimin blerës te cdo materiali dhe fitimin per këtë pozicion.*

OE nuk ka dhënë sqarime bindëse për komisioni se mund t'i furnizoj ato sasie me çmimin abnormalisht te ulet te dhënë ne oferte

Komisioni i vlerësimit ka bere kerkese per sqarime edhe tek analiza financiare OE IGB pas letrës standard ka dhen sqarime per llogaritje te vikendeve ku ka përcaktuar llogaritjen e 15 aktive me nga 2 punëtor, ndërsa ne vikende punohet ne 16 pika.

OE është përgjigjur se caktimi i pikave objekteve shëndetësore është bere duke u bazuar ne web te QKMF-se me pikat e prezentuara ndërsa kjo nuk i qëndron se ky aktivitete përfshinë objektete shëndetësore per KPSH dhe jo per QKMF.

Përveç objekteve te QKMF është edhe një pike e QMU qe përshihet ne shërbimet e këtij aktiviteti.

Komisioni i vlerësimit konstaton se aktiviteti i prokurimit duhet te ANULOHET ne mungese te ofertave te përgjegjshëm por edhe ne mungese te informacioneve te mjaftueshme ne dosje te tenderit.

Ne dosje te tenderit nuk është cekur numri i pikave te objekteve shëndetësore qe punojnë vikendeve, po ashtu edhe OE nuk kane bere pyetje gjate afatit për sqarimin e dosjes se tenderit si rrjedhoje OE ka bere kalkulime te ndryshme na analize financiare. Kjo është një gjë qe nuk mund te rikuperohet ne këtë faze te aktivitetit përfundimisht rekomandojmë anulimin e aktivitetit.

DËSHMITË LIDHUR ME KËRKESAT E PRANUESHMËRISË[2]

Komisioni I vlerësimit rekomandon Anulimin e aktivitetit

Emri i Tenderuesit te cilit Autoriteti Kontraktues ka ndërmend ndër mend që t'ia jap kontratën	Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë PO/JO		Është shpërblyer me kontrate PO/JO
	Certifikata nga Administrata Tatimore	Certifikata nga autoriteti kompetent gjyqësor apo administrativ	Kërkesat të njohura pranueshmërisë (Të specifikuara)
1. NA			

Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit: Visar Shala

Nënshkrimi: _____

Data: 22.11.2023

[2] Të kërkohet vetëm nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën.

B36 Formulari standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve– procedura e hapur

22

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina

SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, TREPQES NR.2 – PRISHTINË

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues

„Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-së"

Numri i aktivitetit te prokurimit

Nr. i prokurimit	616-23-4576-2-1-1
Nr i brendshëm	616 23 100 211

Radhë	Lënda / grupi: Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-së	Çmimi total i ofertës (me TVSH)
1.	Schafberger Jr. GmbH - Dega Kosovë Dega në Kosovë, 811167809	Eleminim
2.	RIO PLUS SH.P.K.811868340	Eleminim
3.	ERIK SH.P.K. 810029018	Eleminim
4	Efa Dienstleistung GmbH - Dega në Kosovë 810804999	Eleminim
5.	Grup i Operatorëve Ekonomik INTERNACIONAL GROUP BASE SH.P.K.; SKYFTERAT - LIVE SH.P.K.	Eleminim
6.	Grup i Operatorëve Ekonomik LAGUNA SH.P.K.; Extreme Clean SH.P.K.	Eleminim

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

AK përmes këtij vendimi ANULON Aktivitetin e prokurimit ne mungese te ofertave te përgjegjshëm por edhe ne mungese te informacioneve te mjaftueshme ne dosje te tenderit. Ne dosje te tenderit nuk është cekur numri i pikave te objekteve shëndetësore qe punojnë vikendeve, po ashtu edhe OE nuk kane bere pyetje gjate afatit për sqarimin e dosjes se tenderit si rrjedhoje OE ka bere kalkulime te ndryshme na analize financiare. Kjo është një gjë qe nuk mund te rikuperohet ne këtë faze te aktivitetit përfundimisht rekomandojmë anulimin e aktivitetit, poashut nuk ka oferta të përgjegjshme për këtë aktivitet.

Data:23.11.2023
Emri dhe mbiemri i ZPP:
Visar Shehu

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina

SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Letër standarde për *[tenderuesin]* e eliminuar[4]

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, TREPQES NR.2 - PRISHTINË

Operatori Ekonomik: "Efa Dienstleistung GmbH - Dega në Kosovë", 810804999

Titulli: „Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-së"

Numri i aktivitetit te prokurimit

Nr. i prokurimit	616-23-4576-2-1-1
Nr i brendshëm	616 23 100 211

Te nderuar

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në *dosjen e tenderit*. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

[Tenderi i juaj] është administrativisht i papërgjegjshme:

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

- **Ju nuk keni plotësuar kërkesën e dosjes 1.Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit fiskale ka qenë prej jo më pak se 900.000,00 Euro, OE ka sjell dëshmi CD për vitet 2020, 2021 dhe 2023, qe ne total bëjnë 821,00 dhe jo 900,000. OE nuk e ka plotesuar si duhet FDT, tek nen kriteri për shpeshtinë OE është dashur te caktoj sa here do te intervenoj ne një ndërrim prej 1 deri ne max 3, ndërsa OE ka dhënë shënim 7 here ne dite dhe ne javë 17 here, dmth OE nuk ju ka përmbajtur te dhënave te AK, aq me shume kur kemi te bëjmë me plotësim te FDT qe është kusht administrative.**
  Tek analiza financiare OE nuk e ka plotësuar si duhet analizën financiare sepse nuk e ka bere llogaritjen e festive konform ligjit dhe kërkesës se dosjes, poashtu kontributin e punëdhënësit e ka llogaritur dy here ne kalkulim te shpenzimeve.
  OE nuk e ka plotësuar kërkesën me dëshmitë përcjellëse 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjtë

pastrim në vlerë minimale prej 800.000,00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë).
OE pas vendimit te AK-se ka sjell ne sistem disa dëshmi për qarkullim financiar – pasqyra financiare nga kompania Ame ne Gjermani, por qe sipas komisionit kompania ka ofertuar e vetme dhe dokumentet tjera nuk janë relevante ne ofertën e prezantuar ne fillim.
OE ka sjell dëshmi te referencave ne gjuhen zyrtare gjuhen shqipe vetëm 709,610 euro, te tjerat janë ne gjuhen jo zyrtare ne gjuhen gjermane duke bere shkelje te LPP-neni 13 paragrafi 4.
OE nuk e ka plotësuar kërkesën me dëshmitë përcjellëse.
c) Operatori duhet te jete i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare te menaxhimit te mjedisit, ne lëmine e pastrimit te objekteve ISO Certifikate 14001 2018 (valide). Iso standard për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit ne pune- nuk e ka sjell aspak.
OE nuk e ka plotësuar kërkesën me dëshmitë përcjellëse - 9. Lista e pajisjeve a) Operatori Ekonomik duhet te ketë te gjitha llojet e makinave për pastrimin e dyshemesë dhe lustrimin 18. b) Makinë për larjen e pllakave 1 (një). c) Makinë për thithjen e ujit 4 (katër). d) Makine për larjen dhe terjen e dyshemeve (me akumulator ose me rryme) 15 (pesëmbëdhjete) e) Kova për pastrim 36 (tridhjetë e gjashte) f) Fshesa me korrent 18 (tetëmbëdhjetë) g) Makine për larjen e tepihëve dhe thithjen e ujit. h) 1 (një) Pikap. i) Makinë (kositëse) me motor për kositjen e barit 6 copa. j) (trimer) 8 copë. k) Makine për largimin e bores (freze) 3 copë • l)Karroce e madhe për pastrim te zyrave, sallave te operimit dhe ambienteve te ngjashme 18 cope m) auto kran me lartësi 25m 1 copë n) Kamionete ose traktor për bartje 1 copë-OE nuk I ka ofruar ne sasi te kërkuara, makineria Traktor është me afat te skaduar. OE ka sjell dokumente ne gjuhen gjermane qe nuk është gjuhe zyrtare prandaj dokumentacioni është i papranueshëm.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt!

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

PALE ME INTERES SIPAS NENIT 4.1.26 T? LPP-s?

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Efa Dienstleistung GmbH - Dega në Kosovë**

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues: Autoriteti Kontraktues: Kuvendit komunës Prishtinës ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit me titull: Titulli: "Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-së nr prokurimit 616-23-4576-2-1-1 lloji i kontratës: shërbime , vlera parashikuar e kontratës: 1,250,000.00

Fazat e procedurës se prokurimit:

Njoftimi për kontratë, dhe dosja e tenderit	22.05.2023
Data e ofertimit	23.06.2023
Hapja e ofertave	23.06.2023
Njoftimi i Autoritetit Kontraktues për dhënje kontrate	17.10.2023
Kërkesa për qasje në ofertën e rekomanduar	18.10.2023
Njoftimi mbi pezullimin e aktivitetit	23.10.2023
Njoftimi i Autoritetit Kontraktues vendim për ri-vlerësim të ofertave	30.10.2023
Plotësimi i dokumenteve shtesë	30.10.2023
Njoftimi i Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit	23.11.2023

Kërkesa për rishqyrtim 28.11.202

Njoftimi mbi pezullimin e aktivitetit 29.11.2023

Me datë 23.11.2023 ka nxjerrë Njoftimi i Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit. ku ne te njëjtin vendim ka njoftuar edhe tenderuesit te tjerë me letër standarde përmes sistemit E-Prokurim për vendimin e marre. OE "Efa Dienstleistung GmbH - Dega ne Kosove"- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me 28.11.2023, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Pastrimi i objekteve shendetesore te KPSH-se" me nr. të prokurimit: "616-23-4576-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES . NDERSA Vendimi i AK-së në kërkesë për rishqyrtim te dt 28.11.2023 OE OE "Efa Dienstleistung GmbH - Dega ne Kosove"- Prishtinë me dt 23.11.2023 .me pas OE i pakënaqur ka parashtruar ankese pran OSHP me dt 15.12.2023 .Si pale me interes për ketë procedure te prokurimit NUK pajtohemi me vlerësimin te pranuar nga AK-ja përmes letrës standarde te tenderuesit te eliminuar dhe vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim sepse përveç qe kemi plotësuar kërkesat e përzgjedhjes po ashtu edhe ato teknike te detyrueshme siç kane qene te specifikuara ne Aneksin 1 te DT

ANKESA PRAN AK - Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES ishte si me poshtë :

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: *Komunën e Prishtinës*

Për Aktivitetin e Prokurimit: me Nr. 616-23-4576-2-1-1 Sa i përket tenderit për: Pastrimi i objekteve të shëndetësore të KPSH-së

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Efa Dienstleistung GmbH Dega në Kosovë

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr: "Rexhep Mala", Nr. 25, Aktash, Prishtinë

(Adresa)

Prishtinë — *10000*

(Vendi) — *(Kodi postar)*

044235532 — *10000*

(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Meriton Morina

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

efagroupshpk@gmail.com

(Adresa elektronike)

28.11.2023

(Data e parashtrimit të kërkesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

2. Identifikimi i avokatit

1/3

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorezimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi pë kontratë, dhe dosja e tenderit 22.05.2023
Data e ofertimit 23.06.2023
Hapja e ofertave 23.06.2023
Njoftimi i Autoritetit Kontraktues për dhënje kontrate 17.10.2023
Kërkesa për qasje në ofertën e rekomanduar 18.10.2023
Vendimi mbi pezullimin e Aktivitetit 23.10.2023
Njoftmiti i Autoritetit Kontraktues vendim për ri-vlerësim të ofertave 30.10.2023
Plotësimi i dokumenteve shtesë 30.10.2023
Njoftimi i Autoritetit Kontraktues për anulimin e procedures e aktivitetit 23.11.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] **Jo** [ ]

2/3

Hapja e ofertave është bërë me datën 23.06.2023 sipas procedurës në e-prokurim dhe në kohën e paparë.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Bazuar në nenin 4 përkufizimet paragrafi 1.26 Si palë me interes bazuar në dispozitata e LLP-së përkatësisht neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve. Paraqësim kërkesën për ri-shqyrtim Neni 1, Qëllimi Neni 4, Paragrafi. 1.26. Palë e interesuar Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti Neni 7, Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi Neni 53 Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve paragrafi 3 Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës paragrafi 1. Neni 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Të nderuar, Ne kemi ofertuar në shpalljen publike me të dhënat Aktivitetin e Prokurimit Nr.616-23-4576-2-1-1 Sa i përket tenderit për: Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-së.

3/3

Sipas procesveball të hapjes së ofertave në pjesëmarrje ishte edhe një OE i cili sipas njoftimit të AK është i papërgjegjëshëm edhe pse kishte ofertë me të lirë financiare e njëjta kishte dorzuar vetem certifikatën e biznesit dhe paramasen e çmimeve andaj nuk e vlerësuam që të shkruajm më shumë.

Oferta jonë ishte e dyta me radh më çmimin më të lirë të përgjegjëshëm. Bashkangjitur procesverbali i hapjesë së ofertave.

Nisur nga ecuria e procedurës që nga njoftimi i datës 17.10.2023, ku nga komisioni i vlerësimit padrejtësisht është shpallur si papërgjegjëshme oferta jonë me disa arsyetime të cilat po të trajtoheshin sipas dispozitave të Lpp-së oferta jonë do të konsiderohej si oferta më e lirë e përgjegjëshme.

Për qudi komisioni kishte kaluar ofertën tonë duke e shpallur fituese ofertën më çmim me të lartë ku tash më në njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit e gjithë oferta e rekomandurë ishte me plot gabime.

Pas njoftimit të autoritetit tuaj ne më datën 17.10.2023 kemi kërkuar interpretim të kritereve të cilat ishin në dosjën e tenderit, dokumenteve të cilat i kishim prezatuar dhe arsyetimet në njoftimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Prishtinës.

Kominisioni Rregullativ për Prokurim Publik më datën 27.10.2023 është përgjigjur kërkesës sonë.

Në posa kemi pranuar intepretimin ligjore të Kominisioni Rregullativ për Prokurim Publik, u jemi drejtuar me shkresë sqaruese duke sqaruar në përpikëmri arsyetimet që ju keni dhën në njofitmin për ofertën tonë për ta shpallur si të papërgjegjëshme.

- Deshmi shkresë për sqarim dhe argumentim të ofertës sonë
- Intepretimi i krpp-së;
- Qarkullimi financiare, i përkthyer dhe i noteruar në gjuhën shqipe nga kompania amë në Gjermani;
- Iso standartet sipas kërkesave të dosjës së tenderit të përkthyera dhe të noteruara të njejtat nga TUV.

Si të pa mjaftushme për ju të gjitha keto dokumetë duke mos i tratuar dispozitat ligjore për të kërkuar sqarim apo argumentim të pikav nga të cilat keni shpallur ofertën tonë si të pa përgjegjëshme.

Më datën 23.11.2023 jemi njoftuar për anulimin aktivitetin në tërsi, duke parë që edhe në procesin e ri-vlerësimit nuk i keni trajtuar ofertën tonë sipas kritereve dhe dispozitave ligjore primare dhe sekondare të Lpp-së.

Ne paraqesim kërkesë për ri-shyrtim

Në njoftimin tuaj ju keni dhën arsyetime edhe për shum pika të tjera të cilat ishin të plotësura.

4/3

Arsyetimi në njoftim të vendimit tuaj, duke thën se:

- *Ju nuk keni plotësuar kërkesën e dosjes 1. Operatori Ekonomik duhet ti ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetorë i Operatorit Ekonomik gjatë tre viteve të fundit fiskal ka qenë prej jo më pak së 900,000.00 euro, OE ka sjell CD për vitet 2020, 2021, dhe 2023 që në total bëjnë 821,000 dhe jo 900,000.00.*

Ne bashkë me ofertën tonë kishim prezatuar qarkullimin nga banka ku tejkalohet vlera të cilën keni kërkuar në dosjen e tenderit.

Dispozitat e nenit:

Neni 68
Gjendja Ekonomike dhe Financiare

1. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të parashtrojnë të dhëna për të treguar se ata i përmbushin kushtet minimale ekonomike dhe financiare të specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Kur kërkohet, qarkullim minimal vjetor që operatorët ekonomik duhet të kenë nuk do të kalojë dy herë vlerën e parashikuar të kontratës. Kërkesat mbi gjendjen ekonomike duhet të shprehen detyrimisht në shifra dhe do ti referohen maksimum tri viteve të fundit financiare. Kur përveç qarkullimit minimal, është i nevojshëm një qarkullim i caktuar minimal në fushën specifike të mbuluar nga kontrata, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë një pikë pesë (1.5) herë vlerën e parashikuar të kontratës. **Në përgjithësi, operatorëve ekonomik u lejohet të plotësojnë këtë kërkesë duke paraqitur, nëse është me rëndësi dhe e nevojshme, një ose më shumë nga referencat e dhëna në vijim:**

1.1. raportin ose raportet përkatëse nga një ose më shumë banka; të renditura si në tabel.

UDHEZUES Nr. 001/2023 PER PROKURIMIN PUBLIK

2. Gjendja ekonomike dhe financiare	**a) Kërkesat minimale të gjendjes ekonomike/ financiare**	**a. Deklaratë adekuate ose deklarata nga një ose më shumë banka; ose**
		b. Dëshmi të policës relevante të sigurimit të lëshuar nga një kompani e licencuar dhe me reputacion; ose
		c. Kopje të certifikuara të një ose më shumë pasqyrave të bilancit ose pjesë të pasqyrës së bilancit; ose
		d. Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur; ose

5/3

		e. Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.

Njera nga pikat të cilat mund të pranoj qarkullimi edhe nga raporet bankare, duke parë këto raporte AK është dashurë të kërkoj sqarime shtesë për të argumentuar dokumentet në ofertën tonë në qfarë do forme do i plotësonim.

a. Deklaratë adekuate ose deklarata nga një ose më shumë banka; ose

Të renditura në fillim që dipozitave të Lpp-së qarkullimi bankarë i dorzuar nga në është dashur të pranohët, apo nese të njëtin nuk është dukur si pranueshëm ju duke zbatuar dispozitat ligjore primare të:

Lpp-së neni 68 paragrafi **1** si dhë

UDHEZUES Nr. 001/2023 PER PROKURIMIN PUBLIK

10. Sqarimi i tendereve gjate procesit te vleresimit te tendereve 10.1 Shembujt e meposhtem nuk jane te vetmet raste.

Mungon dëshmia mbi gjendjen ekonomike dhe financire	Mund të kërkohen informata	Neni 68

Në mundësin e zbatimit të nenit 68 që thuhet se "Mungon dëshmia mbi gjendjen ekonomike dhe financire", mund të kërkohen informata. Ne kishim të dorzuara qarkullimet bankare që kalonin vlerën e till shum më shum e që në fakt i bie se kërkesa ndaj nesh për të sqarur këtë pikë ishte mëse e drejt për ofertën tonë.

Arsyetimi në njoftim të vendimit tuaj, duke thën se

- *Tek nën kriteret për shpeshtësin e pastrimit OE është dashur të caktoj sa herë do të intervenoj në një ndrrim prej 1 deri në max 3, ndërsa OE ka dhën shënim 7 here në dite dhe në jave 17 herë, dmth OE nuk ju ka përmbajtur te dhënave të AK, ag me shum kur kemi të bëjmë me plotësimin të FTD që është kusht administrativ.*

Në bashkëkangjtur me ofertën tonë kemi dorzuar deklaratën/planin me titull shpeshtësia e pastrimit siq është kërkuar në FDT. Ju keni kërkuar që ofertat të jenë me poentim dukë thën:

8. Operatori ekonomik duhet te paraqet një plan për shpeshtësisë të pastrimit.	**8. Plani duhet të jetë i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik**

6/3

	Nënkriteret	Koeficient
1	1. Çmimi	0.70
2	2.Operimi (shpeshtësia e pastrimit të sipërfaqeve sipas paramasës) min. 1 herë max 3 herë	0.30

Duke nisur nga kërkesa juaj në dosjen e tenderit

8. Plani duhet të jetë i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik

Për ne kërkesa e till nuk nenkupton kufizim "sepse atëherë nuk do të ishte logjike poentimi" të numrit se sa hërë duhët të pastrohet apo të intervenohet në hapsira të tilla objekte shëndetësore. Plani që në kemi prezantuar përfshin orarin prej 8 orë punë me një 1 orë pauzë duke renditur orarin e punës siq është edhe e rregulluar nga ora 07:30 deri në 15:30.

Adaj, siq edhe e kemi prezantuar planin e punës së sherbimeve është arritur numri 7 herë në ditë është tejet normale veprimi në sipas planit në Deklaratët e Shpeshtësisë që në faktë është dashur ta vlerësoni sipas formules që ishte në dosjen e tenderit në fq. 39, duke i dhën ofetës sone pikët maksimale të poentimit orej 0.30 e që bashkë me çmimin e ofertës sonë do ta arrinim të ishim fitues të kësaj kontratë.

- Prove: Do të ri-bashkangjitet plani i shpeshtësisë së pastrimit

Arsyetimi në njoftim të vendimit tuaj, duke thën se

- *Tek analiza finaciare OE nuk e ka plotësuar si duhet analizën finaciare sepse nuk e ka bërë llogaritëjen e festive konform ligjit dhe dosjes së tenderit, poashtu kontributet e punëdhënësit e ka llogaritur dy herë në kalkulimin e shpenzimeve.*

2. OE duhet te deklarohet se do ti paguan te gjithë punëtorët pagat e njëjta me punëtorët e këtij sektori ne BRUTO prej 300.00 euro me te gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit te Punës Nr.03 L-212 ku duhet të llogaritet së paku pushimi vjetor dhe vikendet si dhe ligjeve tjera që rregullojnë marrëdhënien e punës si dhe ATK-se	**2. a), b)Te dëshmohet me deklarate origjinale e nënshkruar dhe e vulosur nga OE si dhe analizën financiare te detajuar (origjinal).**

Duke u bazur në pjesën e kopjuar nga dosja, lidhur me pagat dhe të drejtat të tjera të të punësuarve nuk është kërkuar që punëtorët të paguhen apo të kryejnë shërbime edhe ditëve të festave, adaj edhe nuk e kemi kalkuar sherbimet në ditë të festave. Analiza finaciare e ofertës sonë është e bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit.

Ju keni then se ne kemi kalkuluar në analizën financiare dy herë trustin pensional të të punësuarve e vertet që një emërtim në analizën finaciare është mbeturë si emërtimin trustet pensionale. Por, vlera e till nuk mund të konsiderohet gabim pasi që tërsia e ofertës

7/3

sone e dhën në fund të analizës financiare dhe në paramasën e çmimev nuk dallon as edhe një 0.01 cent.

Prandaj, vlera e till me emërtim trustet pensionale do të mund të përfshihet në zbatimin, furnizimin dhe pagesa të ndryshme për të ofruar sherbime sa më cilësore për projktin në fjalë apo mund të konderohej edhe fitim i mundshëm i kompanisë. Pranushmëria e saj nuk do të ishte shkelje pasi që vlerat e dhëna nuk përbëjn gabim aritmetik.

Arsyetimi në njoftim të vendimit tuaj

- *Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukeses kontrata të natyres së njëjtëpastrimi në vlerën prej 800.000,00 euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë)*

OE pas vendimit të AK-së ka sjellur në sistem disa dëshmi për qarkullim financiarë pasqyra financiare nga kompania Ame në Gjermani, por që sipas komisionit kompania ka ofertuar si e vetme dhe dukumentet tjera nuk janë relevante në ofertën e prezantuar në fillim.

Sqarim në ofertën tonë kemi durzuar qarkullimet lista e kontratve me referenca që kalon disa hërë këtë vlerë. Është për tu habitur se si komisoni ka shtuar arsyetime të pa qena dhe aspak të vertëta duke then se kemi sjellur dokumente "referenca në gjuhën Gjermane që në faktë nuk është e saktë sepse është e përkthyer në gjuhën shqipe që do e ribashkangjesim prap bashkë me kërkesen për ri-shqyrtim.

- Deshmi referenca në gjuhën gjermane dhe gjuhën shqipe e përkthyer tek përkthyes gjyqesore.

Deshmi do të ribshkangjesim listet e kontrave me referenca për rideshmuar edhe një hërë arsyetimin që ju keni dhën.

Sa për korrektësi dhe sqarim ligjore në ëeb të Krpp-së është shpallur interpretimi se nuk kompanit me juridiksion si degë e huaj në vendin tonë nuk kan nevoj të lidhin konsiorciume dhe si te tilla mund të përdorën dokumente të kompanisë amë.

Cfar do dukumenti që ne kemi sjell i cili është në gjuhën Gjermane është i përkthyer dhe i noteruar në gjuhën Shqipe gjë të cilën prap do e bashkangjesim me kërkesën për rivlerësim.

- Provë: Interpretimi i Krpp-së lidhur me degët e huaja "përdorimin e dokumenteve"

Arsyetimi në njoftim të vendimit tuaj

- *Me datën 23.06.2023 kur edhe ishte data e ofertimit bashkë me ofertën kemi dorzuar, prezantuar standartet nga TUV-Gjermani dhe Isa nga Rig Cert Shqipëri.*

Iso 14001-2018, Iso 9001- 2015, Iso 45001-2018

8/3

Në njoftimin e pare keni thën se ju keni prezatuar ISO në gjuhën Gjermane që në fakte është se:

Iso 45001-2018 është ishte prezantuar në Gjuhën Shqipe dhe e noteruar ndërsa për Iso 14001-2018, Iso 9001- 2015 ishin të prezantuara në Gjuhën Gjermane por të njëjat ishin të notëruara në gjuhën Shqipe.

Gjatë fazës së ri-vlerësimit ne e kemi përkthyer rresht për rresht në gjuhën Shqipe dhe u a kemi derguar të njëjtat.

Në njoftimin e fudit nga ana juaj 23.11.2023 ju keni thën se "Iso standard për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit në punë-nuk e keni sjell aspak". Gjë e cila nuk është e saktë se: Bashkë me ofertën është prezantuar ky standard që të cilën do të u'a ri dergojm prap si dëshmi nga sistetmi i-eprokurimit që e kishim dorzuar.

Neni 69
Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

2.5 certifikatave të hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë ose agjencitë kompetente të pranuara që vërtetojnë përshtatshmërinë e produkteve, që qartazi mund të identifikohen duke u bazuar në specifikimet dhe standardet përkatëse

Bazuar në dispozitat e Lpp-së dhe UDHEZUES Nr. 001/2023 PER PROKURIMIN PUBLIK

Mungon certifikata ISO	Mund të kërkohen informata sqaruese	Neni 69

Arsyetimi në njoftim të vendimit tuaj, ku keni thën se:

OE nuk e ka plotësuar kërkesën me dëshmitë përciellése

Pjesë e kopjuar nga kërkesa në dosjen e tenderit

9. Lista e pajisjeve a) Operatori Ekonomik duhet te ketë te gjitha llojet e makinave për pastrimin e dyshemesë dhe lustrimin 18. b) Makinë për larjen e pllakave 1 (një). c) Makinë për thithjen e ujit 4 (katër). d) Makine për larjen dhe terjen e dyshemeve (me akumulator ose me rryme) 15 (pesëmbëdhjete) e) Kova për pastrim 36 (tridhjetë e gjashte) f) Fshesa me korrent 18 (tetëmbëdhjetë) g) Makine për larjen e tepihëve dhe thithjen e ujit. h) 1 (një) Pikap. i) Makinë	**9. Evidenca Lista e pajisjeve a) Operatori Ekonomik duhet te ketë te gjitha llojet e makinave për pastrimin e dyshemesë dhe lustrimin 18. b) Makinë për larjen e pllakave 1 (një). c) Makinë për thithjen e ujit 4 (katër). d) Makine për larjen dhe terjen e dyshemeve (me akumulator ose me rryme) 15 (pesëmbëdhjete) e) Kova për pastrim 36 (tridhjetë e gjashte) f) Fshesa me korrent 18 (tetëmbëdhjetë) g) Makine për larjen e tepihëve dhe thithjen e ujit. h) 1 (një) Pikap. i) Makine (kositëse) me motor për**

9/3

(kositëse) me motor për kositjen e barit 6 copa. j) (trimer) 8 copë. k) Makine për largimin e bores (freze) 3 copë • l)Karroce e madhe për pastrim te zyrave, sallave te operimit dhe ambienteve te ngjashme 18 cope m) auto kran me lartësi 25m 1 copë n) Kamionete ose traktor për bartje 1 copë	**kositjen e barit 6 copa. j) (trimer) 8 cope. k) Makine për largimin e bores (freze) 3 copë • l)Karroce e madhe për pastrim te zyrave, sallave te operimit dhe ambienteve te ngjashme 18 cope m) auto kran me lartësi 25m 1 copë n) Kamionete ose traktor për bartje 1 copë Listës duhet ti bashkëngjiten, njëra nga këto dëshmi, DUD doganorë apo faturë për blerjen ose kontrata mbi qiramarrjen – kopje.**

Edhe ky arsyetim është i pa saktë sepse bashkangjitur me ofertën keni të gjitha dëshmit duke filluar nga Libreza për autorjete e makineri, duda doganorë, marrëveshje të kompanisë, kontrata për furnizim, fatura të blerjes etj.

Për të të saktësuar të thenat tona nga sistemi e-prokurimit si edhe i kemi dorzuar do të u nënvizojm secilën nga pikat në kërkesën e dosjes së tenderit.

Dhe sa i përketë thënjes suaj në njoftimin e vendimit tuaj se Traktori është në afat të skaduar "Traktori" nuk është me afat skadence në ketë renditje të dokumenteve keni pasur të prezanatuar " MARRVESHJE" të cilat do të mbulonin secilën pikë të kërkuar. Edhe pikën e traktorit me kamion per bartëje të ndryshme.

Bazuar në ato që u than më lartë kërkojm nga ju që lëndën ta ktheni në ri-vlerësim duke vlerësuar në përpikmëri të gjitha dokumentet në ofertën tonë si dhe dëshmit dhe sqarimet e vazhdueshme që ne kemi bërë për ofertën tonë.

Bashkangjitur nga sistemi i e-prokurimit

1. Lista e kontrave me referenca, e dorzuar bashk me ofertën e datës 23.06.2023;
2. Qarkullimi i perkthyer në gjuhën;
3. Iso standarted të noteruara dhe të perkthyera në gjuhën Shqipe;
4. Interpretimi ligjore i Krpp-së, lidhur me degët e huja dhe perdorimin e dokumenteve nga kompanit amë në vendin tonë;
5. Interpretimi ligjore Krpp-së lidhur me mundësit e kërkesave mbi gjendjen ekonomiko finaciare.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Pergaditja e ofertave, sigurimi tenderit, vazhdimi e sigurimit të tenderit, kërkesa për ri-shqyrtim, koha e humbur, stresi krijuar, mundësi reale e fitimit të kontratës etj.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

10/3

Pergjigja e Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES ishte si me poshtë:

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina
SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim e datës 28.11.2023 të operatorit ekonomik "Efa Dienstleistung GmbH - Dega në Kosovë" Sh.P.K. kundër njoftimit mbi vendimin e datës 23.11.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-23-4576-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

VENDIM

I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Efa Dienstleistung GmbH - Dega në Kosovë" Sh.P.K. e datës 28.11.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 23.11.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-23-4576-2-1-1.

II. **VËRTETOHET** njoftimi mbi vendimin e datës 23.11.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.

III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Efa Dienstleistung GmbH - Dega në Kosovë" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën https://e-prokurimi.rks-gov.net.

IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Efa Dienstleistung GmbH - Dega në Kosovë" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 28.11.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 23.11.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-23-4576-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Pretendimet kryesore të parashtruesit kanë të bëjnë me faktin se parashtruesi i kundërshton të gjitha arsyet për eliminimin e ofertës së tij si tenderues të papërgjegjshme sikurse janë përcaktuar me letrën standarde për tenderuesin e eliminuar si dhe me raportin e komisionit vlerësues.

Arsyet për eliminimin e parashtruesit janë evidentuar si në vijim:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

- **Ju nuk keni plotësuar kërkesën e dosjes 1.Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit fiskale ka qenë prej jo më pak se 900.000,00 Euro, OE ka sjell dëshmi CD për vitet 2020, 2021 dhe 2023, qe ne total bëjnë 821,00 dhe jo 900,000. OE nuk e ka plotesuar si duhet FDT, tek nen kriteri për shpeshtinë OE është dashur te caktoj sa here do te intervenoj ne një ndërrim prej i deri ne max 3, ndërsa OE ka dhënë shënim 7 here ne dite dhe ne jave 17 here, dmth OE nuk ju ka përmbajtur te dhënavo te AK, aq me shume kur keni te bëjnë me plotësim te FDT qe është kusht administrative.**
  Tek analiza financiare OE nuk e ka plotësuar si duhet analizën financiare sepse nuk e ka bere llogaritjen e festive konform ligjit dhe kërkesës se dosjes, poashtu kontributin e punëdhënësit e ka llogaritur dy here ne kalkulim te shpenzimeve.
  OE nuk e ka plotësuar kërkesën me dëshmitë përcjellëse 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjtë pastrim në vlerë minimale prej 800.000,00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë).
  OE pas vendimit te AK-se ka sjell ne sistem disa dëshmi për qarkullim financiar – pasqyra financiare nga kompania Ame ne Gjermani, por qe sipas komisionit kompania ka ofertuar e vetme dhe dokumentet tjera nuk janë relevante ne ofertën e prezantuar ne fillim.
  OE ka sjell dëshmi te referencave ne gjuhen zyrtare gjuhen shqipe vetëm 709,610 euro, te tjerat janë ne gjuhen jo zyrtare ne gjuhen gjermane duke bere shkelje te LPP-neni 13 paragrafi 4.
  OE nuk e ka plotësuar kërkesën me dëshmitë përcjellëse.
  c) Operatori duhet te jete i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare te menaxhimit te mjedisit, ne lëmine e pastrimit te objekteve ISO Certifikate 14001 2018 (vlidej. Iso standard për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit ne punë- nuk e ka sjell aspak.
  OE nuk e ka plotësuar kërkesën me dëshmitë përcjellëse - 9. Lista e pajisjeve a) Operatori Ekonomik duhet te ketë te gjitha llojet e makinave për pastrimin e dyshemesë dhe lustrimin 18. b) Makinë për larjen e pllakave 1 (një). c) Makinë për thithjen e ujit 4 (katër). d) Makine për larjen dhe terjen e dysheme've (me akumulator ose me rryme) 15 (pesëmbëdhjete) e) Kova për pastrim 36 (tridhjetë e gjashte) f) Fshesa me korrent 18 (tetëmbëdhjetë) g) Makine për larjen e tepihëve dhe thithjen e ujit. h) 1 (një) Pikap. i) Makinë (kositëse) me motor për kositjen e barit 6 copa. j) (trimer) 8 copë. k) Makine për largimin e bores (freze) 3 copë • l)Karroce e mudhe për pastrim te zyrave, salluave te operimit dhe ambienteve te ngjashme 18 cope m) auto kran me lartësi 25m 1 copë n) Kamionete ose traktor për bartje 1 copë-OE nuk 1 ka ofruar ne saji te kërkuara, makineria Traktor është me afat te skaduar. OE ka sjell dokumente ne gjuhen gjermane qe nuk është gjuhe zyrtare prandaj dokumentacioni është i papranueshëm.

Duhet theksuar se parashtruesi përmes kërkesës së tij për rishqyrtim askund nuk i ka kontestuar arsyet për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Kujtojmë se ky aktivitet i prokurimit përmes njoftimit mbi vendimin e datës 23.11.2023 është anuluar në përputhje me nenin 62 të LPP lidhur me nenin 43 të RRPP, për arsyet e evidentuara si në vijim:

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:
AK përmes këtij vendimi ANULON Aktivitetin e prokurimit ne mungese te ofertave te përgjegjshëm por edhe ne mungese te informacioneve te mjaftueshme ne dosje te tenderit. Ne dosje te tenderit nuk është cekur numri i pikave te objekteve shëndetësore qe punojnë vikendeve, po ashtu edhe OE nuk kane bere pyetje gjate afatit për sqarimin e dosjes se tenderit si rrjedhoje OE ka bere kalkulime te ndryshme na analize financiare. Kjo është një gjë qe nuk mund te rikuperohet ne këtë faze te aktivitetit përfundimisht rekomandojmë anulimin e aktivitetit, poashut nuk ka oferta të përgjegjshme për këtë aktivitet.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Përderisa parashtruesi nuk ka adresuar asnjë pretendim ankimor drejtuar arsyeve për anulimin e aktivitetit të prokurimit, kjo nënkupton që këto arsye përbëjnë fakte të pakontestueshme edhe për vet parashtruesin.

Parimisht parashtruesi nuk i konteston as arsyet për eliminimin e tij si të papërgjegjshëm pasi që me shumicën prej tyre pajtohet (nuk i konteston) si gjendje faktike por vetëm shton se ato nuk përbëjnë arsye të mjaftueshme për eliminim. Si shembull, sa i përket faktit që parashtruesi ka dorëzuar CD për vitet 2020, 2021 dhe 2023 që në total bëjnë 821,000 euro dhe jo 900,000 euro, parashtruesi nuk e konteston faktin që me dosje të tenderit janë kërkuar 900,000 euro dhe as nuk e konteston faktin që sipas dëshmive që ka sjellur ai ka dëshmuar qarkullimin vetëm për 821,000 euro. Konkretisht arsyeja për eliminimin e parashtruesit është formuluar si në vijim:

> *Ju nuk keni plotësuar kërkesën e dosjes 1. Operatori Ekonomik duhet ti ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetorë i Operatorit Ekonomik gjatë tre viteve të fundit fiskal ka qenë prej jo më pak së 900,000.00 euro, OE ka sjell CD për vitet 2020, 2021, dhe 2023 që në total bëjnë 821,000 dhe jo 900,000.00.*

Megjithatë parashtruesi shton se autoriteti kontraktues ka pasur mundësi që të kërkoj sqarime shtesë duke i dhënë shancë parashtruesit që të dërgoj dokumente tjera shtesë për të përmbushur këtë kërkesë të dosjes së tenderit. Fillimisht duhet potencuar se autoriteti kontraktues nuk është aspak i obliguar që përmes sqarimeve shtesë të mbuloj ose të plotësoj gabimet që i bëjnë tenderuesit me rastin e dorëzimit të ofertave të tyre tenderuese. Pra kompletimi dhe dorëzimi i ofertave të kompletuara është interes i operatorëve ekonomik ekskluzivisht. Në rastet e parashikuara sipas LPP, autoriteti kontraktues vlerëson dhe ka diskrecionin që të vendos ose jo për të kërkuar sqarime shtesë. Në rastin konkret nuk janë përmbushur këto kushte sepse dokumentet e dorëzuara kanë qenë të mjaftueshme për komisionin vlerësues që të vendos në mënyrën si ka vendosur. Kjo vlen edhe për arsyen tjetër të eliminimit respektivisht pretendimit ankimor që ka të bëj me çertifikatat ISO (shih kërkesën për rishqyrtim). Por edhe po të ishte gjendja faktike ashtu sikurse e pretendon parashtruesi (që nuk është aspak), sërish një veprim i tillë nuk do të kishte logjikë sepse parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme edhe për shumë arsye të tjera. Pra nuk është kjo kërkesa e vetme e dosjes së tenderit që nuk e ka përmbushur parashtruesi por ekzistojnë edhe shumë kërkesa të tjera të evidentuara me raport vlerësues dhe letrës standarde për tenderuesin e eliminuar.

Një arsye tjetër për eliminimin e parashtruesit është edhe kjo si në vijim:

> *Tek nën kriteret për shpeshtësin e pastrimit OE është dashur të caktoj sa herë do të intervenoj në një ndrrim prej 1 deri në max 3, ndërsa OE ka dhën shënim 7 here në dite dhe në java 17 herë, dmth OE nuk ju ka përmbajtur te dhënave të AK, aq me shum kur kemi të bëjmë me plotësimin të FTD që është kusht administrativ.*

Sa i përket kësaj arsyeje të eliminimit, parashtruesi në kërkesën për rishqyrtim thotë se:

> Për ne kërkesa e till nuk nenkupton kufizim "sepse atëherë nuk do të ishte logjike poentimi" të numrit se sa herë duhët të pastrohet apo të intervenohet në hapsira të tilla objekte shëndetësore. Plani që në kemi prezantuar përfshin orarin prej 8 orë punë me një 1 orë pauzë duke renditur orarin e punës siq është edhe e rregulluar nga ora 07:30 deri në 15:30.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Pra nga mënyra se si është formuluar pretendimi ankimor i cituar si më sipër, lehtësisht mund të konfirmohet fakti se për parashtruesin nuk është kontestuese që i njëjti nuk e ka përmbushur kërkesën e dosjes së tenderit për të cilën po bëhet fjalë (që është kusht administrativ). Parashtruesi vetëm aludon se nuk është arritur të bindet me këtë argumentim të komisionit vlerësues duke thënë se "për ne kërkesa e tillë nuk nënkupton kufizim". Me këtë rast duhet sqaruar se kërkesat e dosjes së tenderit duhet të respektohet tërësisht me rastin e vlerësimit të tenderëve në një aktivitet të prokurimit. Pra qëllimi i dosjes së tenderit nuk është që të bind një tenderues ose tjetrin por përkundrazi, qëllimi është që tenderuesi të bind autoritetin kontraktues se e përmbush kriterin e dhënies së tenderit. Pra nuk mund të thuhet se "kjo për ne nuk përbën kufizim" sepse kufizimet e përcaktuara me dosje të tenderit janë të vlefshme dhe obligative për të gjithë tenderuesit pa përjashtim dhe në përputhje të plotë me parimet e LPP për mosdiskriminim. Sidoqoftë, nuk është kontestuese që parashtruesi nuk e ka plotësuar planin e shpeshtësisë së pastrimit ashtu sikurse është kërkuar me dosje të tenderit prandaj edhe ky pretendim i tij është i pabazuar në tërësi.

Një arsye tjetër për të cilën është eliminuar parashtruesi si tenderues i papërgjegjshëm është edhe kjo si në vijim:

Tek analiza finaciare OE nuk e ka plotësuar si duhet analizën finaciare sepse nuk e ka bërë llogaritëjen e festive konform ligjit dhe dosjes së tenderit, poashtu kontributet e punëdhënësit e ka llogaritur dy herë në kalkulimin e shpenzimeve.

Kërkesa e dosjes së tenderit për të cilën bëhet fjalë në këtë rast është formuluar si vijon:

2. OE duhet te deklarohet se do ti paguan te gjithë punëtorët pagat e njëjta me punëtorët e këtij sektori ne BRUTO prej 300.00 euro me te gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit te Punës Nr.03 L-212 ku duhet të llogaritet së paku pushimi vjetor dhe vikendet si dhe ligjeve tjera që rregullojnë marrëdhënien e punës si dhe ATK-se	**2. a), b)Te dëshmohet me deklarate origjinale e nënshkruar dhe e vulosur nga OE si dhe analizën financiare te detajuar (origjinal).**

Në anën tjetër pretendimi ankimor lidhur me këtë arsye të eliminimit është si në vijim:

Duke u bazur në pjesën e kopjuar nga dosja, lidhur me pagat dhe të drejtat të tjera të punësuarve nuk është kërkuar që punëtorët të paguhen apo të kryejnë shërbime edhe ditëve të festave, adaj edhe nuk e kemi kalkuar sherbimet në ditë të festave. Analiza finaciare e ofertës sonë është e bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit.
Ju keni then se ne kemi kalkuluar në analizën financiare dy herë trustin pensional të të punësuarve e vertet që një emërtim në analizën finaciare është mbeturë si emërtimin trustet pensionale. Por, vlera e till nuk mund të konsiderohet gabim pasi që tërsia e ofertës

Pra nga mënyra se si është formuluar pretendimi ankimor i cituar si më sipër, parashtruesi pretendon se nuk është kërkuar kalkulimi për vikende, pushim vjetor, festa dhe ditët tjera sipas ligjit të punës në fuqi. Në anën tjetër në kërkesën e dosjes së tenderit ky fakt është përcaktuar shprehimisht siç është cituar edhe më sipër. Sa i përket faktit që është kalkuluar dy herë trusi pensional, parashtruesi as që e konteston këtë fakt por vetëm e cilëson si veprim që nuk është gabim duke aluduar se është emërtim i gabuar. Pra nuk ekziston asnjë dilemë që pretendimi ankimor është i pabazuar në tërësi pasi që de facto arsyeja për eliminim nuk kontestohet as nga vet parashtruesi.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Të pretendimet ankimore të parashtruesit janë trajtuar dhe shqyrtuar me kujdes nga zyrtari përgjegjës i prokurimit. Me këtë rast është konfirmuar në mënyrë të pakontestueshme që oferta e parashtruesit është e papërgjegjshme dhe me të drejtë është eliminuar si tenderues nga ky aktivitet i prokurimit. Për më tepër është konfirmuar që arsyet për të cilat është anuluar aktiviteti i prokurimit janë arsye të bazuara në tërësi dhe në përputhje të plotë me nenin 62 të LPP si dhe nenin 43 të RRPP (përndryshe ky fakt nuk është kontestuar në asnjë pjesë të kërkesës për rishqyrtim as nga vet parashtruesi).

Duke marrë parasysh të thënat më sipër, mënyrën e formulimit të pretendimeve ankimore në kërkesën për rishqyrtim, por edhe të gjeturat e komisionit sipas raportit vlerësues është gjetur se oferta e parashtruesit është e papërgjegjshme dhe i njëjti është eliminuar si tenderues.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 07.12.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:
Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Eksperti shqyrtues i prokurimit, sipas autorizimit nr: 2023/1019, , dhe në pajtim me nenin 114 të LPP-së ka shqyrtuar pretendimet e OE "Efa Dienstleistung GmbH - Dega ne Kosove"- Prishtinë ku pretendon se janë shkelur LPP NE DISA NENE SI ME POSHTE

Neni 1, Qëllimi, Neni 4, Paragrafi. 1.26. Palë e interesuar Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7, Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi Neni 53 Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve paragrafi 3 Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës paragrafi 1. Neni 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë,

Eksperti shqyrtues sipas Dokumentit te Ofruar nga platforma elektronike dhe te marra ne dosjen e tenderit dhe dokumentacionit Operatoret ekonomit ne platformën elektronike dhe duke u bazuar ne pretendimet e dhëna nga Autoriteti Kontraktues për eliminimin e OE ku ka kërkuar ne te cilën pretendon qe nuk janë te plotësuara te Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe profesional:** **1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjtë pastrim në vlerë minimale prej 800.000,00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë).**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **1. Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 7 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te shërbimeve.**
		2. OE duhet te deklarohet se do ti paguan te gjithë punëtorët pagat e njëjta me punëtorët e këtij sektori ne BRUTO prej 300.00 euro me te gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit te Punës Nr.03 L-212 ku duhet të llogaritet së paku pushimi vjetor dhe vikendet si dhe ligjeve tjera që rregullojnë marrëdhënien e punës si dhe ATK-se	**2. a), b)Te dëshmohet me deklarate origjinale e nënshkruar dhe e vulosur nga OE si dhe analizën financiare te detajuar (origjinal).**
		5. a) Operatori Ekonomik duhet te jete i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë ne lëmin e pastrimit te objekteve, me ISO Certifikate 9001 2015 (valide). b) Operatori duhet të jete i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare te menaxhimit te shëndetit dhe sigurisë ne pune, ne lëmine e pastrimit te objekteve OHSAS Certifikate 45001 2018 (valide). c) Operatori duhet te jete i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare te menaxhimit te mjedisit, ne lëmine e pastrimit te objekteve ISO	**5. Për piken (a), (b), (c); Te dëshmohet me certifikatat përkatëse për secilën (kopje). SHENIM ME RENDESI - Certifikatat duhet te posedojnë linkun e faqes për verifikim online te validitetit te certifikatave!**

			Certifikate 14001 2018 (valide). Iso standard për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit ne pune.	
			9. Lista e pajisjeve a) Operatori Ekonomik duhet te ketë te gjitha llojet e makinave për pastrimin e dyshemesë dhe lustrimin 18. b) Makinë për larjen e pllakave 1 (një). c) Makinë për thithjen e ujit 4 (katër). d) Makine për larjen dhe terjen e dyshemeve (me akumulator ose me rryme) 15 (pesëmbëdhjete) e) Kova për pastrim 36 (tridhjetë e gjashte) f) Fshesa me korrent 18 (tetëmbëdhjetë) g) Makine për larjen e tepihëve dhe thithjen e ujit. h) 1 (një) Pikap. i) Makinë (kositëse) me motor për kositjen e barit 6 copa. j) (trimer) 8 copë. k) Makine për largimin e bores (freze) 3 copë • l)Karroce e madhe për pastrim te zyrave, sallave te operimit dhe ambienteve te ngjashme 18 cope m) auto kran me lartësi 25m 1 copë n) Kamionete ose traktor për bartje 1 copë	9. Evidenca Lista e pajisjeve a) Operatori Ekonomik duhet te ketë te gjitha llojet e makinave për pastrimin e dyshemesë dhe lustrimin 18. b) Makinë për larjen e pllakave 1 (një). c) Makinë për thithjen e ujit 4 (katër). d) Makine për larjen dhe terjen e dyshemeve (me akumulator ose me rryme) 15 (pesëmbëdhjete) e) Kova për pastrim 36 (tridhjetë e gjashte) f) Fshesa me korrent 18 (tetëmbëdhjetë) g) Makine për larjen e tepihëve dhe thithjen e ujit. h) 1 (një) Pikap. i) Makine (kositëse) me motor për kositjen e barit 6 copa. j) (trimer) 8 cope. k) Makine për largimin e bores (freze) 3 copë • l)Karroce e madhe për pastrim te zyrave, sallave te operimit dhe ambienteve te ngjashme 18 cope m) auto kran me lartësi 25m 1 copë n) Kamionete ose traktor për bartje 1 copë Listës duhet ti bashkëngjiten, njëra nga këto dëshmi, DUD doganorë apo faturë për blerjen ose kontrata mbi qiramarrjen – kopje.

Dhe pasi qe as njeri nga këto kërkesa nga dosja e tenderit nuk janë kushte Administrativ AK Komuna Prishtinës është dashur te shfrytëzoi Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,

I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092Neni 72

Dokumentacioni dhe informacioni shtesë dhe **Interpretimi I Komisionit dt 27.10.2023Interpretimi i Krpp-së 11.05.2023** te bashkangjitura nga OE dhe neneve te poshtë shënuara

Neni 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare

1. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të parashtrojnë të dhëna për të treguar se ata i përmbushin kushtet minimale ekonomike dhe financiare të specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Kur kërkohet, qarkullim minimal vjetor që operatorët ekonomik duhet të kenë nuk do të kalojë dy herë vlerën e parashikuar të kontratës. Kërkesat mbi gjendjen ekonomike duhet të shprehen detyrimisht në shifra dhe do ti referohen maksimum tri viteve të fundit financiare. Kur përveç qarkullimit minimal, është i nevojshëm një qarkullim i caktuar minimal në fushën specifike të mbuluar nga kontrata, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë një pikë pesë (1.5) herë vlerën e parashikuar të kontratës. Në përgjithësi, operatorëve ekonomik u lejohet të plotësojnë këtë kërkesë duke paraqitur, nëse është me rëndësi dhe e nevojshme, një ose më shumë nga referencat e dhëna në vijim:

Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,

I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092Neni 72

Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

3. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm

për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Po ashtu rregullorja thekson 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK

duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së

Mungon dëshmia mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	Mund të kërkohen informata sqaruese	68

Pra pretendimet e OE "Efa Dienstleistung GmbH - Dega ne Kosove"- Prishtinë ku pretendon se jan shkelur LPP Gjendja Ekonomike dhe Financiare Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, **Janë te Bazuara**

Eksperti Shqyrtues per pretendimin e AK ne lidhje me formularin e tenderit i cili eshte plotesuar nga OE "Efa Dienstleistung GmbH - Dega ne Kosove"- Prishtinë ne plateformen e E-prokurimit te **Aneksi 1 Formulari tenderit** qe ishte edhe nenkriter i per te cilen tenderin ne fjale e bente tender jo me çmim me te ulet por Kriter me ekonomikishte me te favorshem Kuvendit komunës Prishtinës ne dosjen e tenderit kishte pergaditur nenkriteret e poshteshenuara ne lidhje me kete aktivitet te prokurimit

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 616-23-4576-2-1-1 Titulli i kontratës: Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-së

Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të

Nën kriteret	Koeficientit

1. Çmimi	**0.70**
2.Operimi (shpeshtësia e pastrimit të sipërfaqeve sipas paramasës) min. 1 herë max 3 herë	0.30

OE "Efa Dienstleistung GmbH - Dega ne Kosove"- Prishtinë ne menyren e poshtshenuar

Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të

Nr.	Nën-kriteri	Koeficient	Përgjigje EO
1	**1. Çmimi**	**0.70**	**34159.18**
2	**2.Operimi (shpeshtësia e pastrimit të sipërfaqeve sipas paramasës) min. 1 herë max 3 herë**	**0.30**	**7 here ne dite dhe ne jave 17 here**

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: **120** nga data finale për dorëzim të tenderëve.

Gjë qe për mua si Ekspert shqyrtues nuk e plotësuar formularin ne mënyrë te duhure dhe te qarte te kolona 2.Operimi (shpeshtësia e pastrimit të sipërfaqeve sipas paramasës) **min. 1 herë max 3** herë **0.30**

Sikur te ishte e shënuar 7 here ne dite dhe ne jave 49 here ndoshta autoriteti kontaktues e kishte notuar me pike maximale koeficientin 30 apo sikur te ishte shënuar 2.42 here ne dite dhe jave 17 here do ti kishte koeficientin 24

Sipas formulës standarde te poentimit

Prandaj UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK e qartëson shumë mire qe ne këto raste duhet te refuzohet tenderi pa kërkuar sqarime shtese

Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ

Eksperti shqyrtues Konstaton se Pretendimi i AK është i bazuar dhe konstatimi i OE qe thote qe nuk mund te behen Kufizime do te ishte ne rregull sikur nje gje te kishte lan 7 here ne dite dhe 49 here ne jave apo te kunderten 2.4 here ne dite apo 17 here ne jave prandaj kjo e bene qe **Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet** dhe Udhezuesi e percakton si **kushte Administrativ** duke **Refuzuar tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm**

Pretendimi i OE "Efa Dienstleistung GmbH - Dega ne Kosove"- Prishtinë." për Formularin e Tenderit
Është i pa bazuar Bazuar

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Efa Dienstleistung GmbH - Dega në Kosovë**

Driton Fetaj